



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Teuta Krasniqi</b>	<b>09.04.2025</b>	<b>26.04.2025</b>	<b>2025/0242</b>

#### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.04.2025, OE “Dua arch SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0242, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Grup i Operatorëve Ekonomik Jana SH.P.K.; ELBAU SH.P.K. , lidhur me aktivitetin e prokurimit: “RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulet” me nr. të prokurimit: "658-24-7751-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA PARTESH.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë,vlera e parashikuar e kontratës: **211,275.30 €**.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/1144 i dt:23.01.2025 Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

#### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 10 i LPP-së

Neni 11 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Pretenimet ankimore për dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 10 i Udhëzuesit Për Prokurim Publik Nr.001/2023

Vendimi i OSHP-së Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025.

#### Kronologji:

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt. **29.07.2024**, kurse njoftimi i parë mbi vendimin e AK-së B58 është publikuar me dt.11.11.2024, ku është rekomanduar për kontratë **Jana SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K. Enver Miftari p.n, Gjilan**, kurse neve na ishte dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar. Ne me 11.11.2024 kishim parashtuar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së e cila e kishte refuzuar si të pabazuar. Pastaj më 22.11.2024 kemi parashtuar ankesë pranë OSHP-së, e cila me Vendimin nr. 2024/1144 e kishte aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe kishte kthyer lëndën në rivlerësim.

Pas rivlerësimit, AK-së më 19.03.2025 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin B58, ku përsëri është rekomanduar për kontratë **Jana SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K. Enver Miftari p.n, Gjilan**, kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

**Grupi Operatoreve Ekonomik DUA ARCH SHPK & PRO&CO GROUP SH.P.K&NNT ABC& NNT BINI nuk i plotëson kriteret e percaktuara në Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, sepse ne dosje te tenderit kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kërkesa mbi makinerit, paisja me nr. 12 (Eskavator me luge ngarkuese para dhe prapa 2 copë), GOE ka dorëzuar një faturë me nr. 29-04-2016 ne gjuhën gjermane e cila është në kundërshtim me nenin 13, pika 4 të LPP Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze. Andaj, oferta juaj vlerësohet si e papergjegjshme nga komisioni i Ri- vlerësues.**

**Ju nuk keni dorëzuar librezën e qarkullimit për mjetin sipas kërkesës së AK-së 9).Damper mbi 3 ton - 1 cope. Ju nuk keni ofruar librezë e qarkullimit me rexhistrim validet por keni ofruar nje Faturë të dates 18.10.2019 me numer 606/19 DUDIN me numër R 8573 të dates 15.04.2019 për makineri Wacker Neuson,Modeli 5001,Viti i prodhimit 2000. Që nuk dëshmon rregullsine teknike dhe regjistrimin e 9).Damper mbi 3 ton - 1 cope. ashtu siq kerkohet ne LIGJIN NR. 05/L-132 PER AUTOMJETET dhe UDHEZIMIN ADMINISTRATIV (MPB) NR.01/2018, PER REGISTRIMIN E MIETEVE.**

**Lidhur me oferten e juaj komisioni i vlersimit dhe ekzaminimit te ofertave ka konstatuar se ju nuk keni arritur te plotesoni Kërkesen sipas nenit 9.1&9.2 të FTD-së**

**për arsye Ju nuk keni dorëzuar librezën e qarkullimit për mjedin sipas kërkesës së AK-së 12).Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa - 2 cope. Ju nuk keni ofruar librezë e qarkullimit me rexhistrim validet por keni ofruar nje DUD për makineri CAT,Modeli 428E,KW:67,Viti i prodhimit 2007. Që nuk dëshmon rregullsinë teknike dhe regjistrimin e Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa ashtu siq kerkohet ne LIGJIN NR. 05/L-132 PER AUTOMJETET dhe UDHEZIMIN ADMINISTRATIV (MPB) NR.01/2018, PER REGISTRIMIN E MIETEVE.**

Sa i përket arsyes së eliminimit për damper mbi 3 ton dhe për eskavator me luge ngarkuese që nuk janë të regjistruar, ju sqarojmë se këto makineri nuk janë obligative të regjistrohen, prandaj nuk mund të eliminohehi për një kërkesë që nuk është obligative.

Sa i përket ligjit që është cekur dhe udhëzimit administrativ, sqarojmë se askund në këtë ligj dhe udhëzim administrativ nuk shkruan se janë obligative regjistrimet për këto pajisje, prandaj vetëm janë cekur këto ligje.

Për më tepër ky projekt ka të bëjë me rregullim të shtratit të lumit dhe nuk ka të bëjë me rrugë dhe asfaltim të rrugëve, kështu që këto pajisje nuk duhet të lëvizin nëpër rrugë.

**Arsyet e eliminimit janë trajtuar edhe në OSHP ku me vendimin PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025 është konstatuar se ne jemi eliminuar padrejtësisht, prandaj kjo arsye e eliminimit është çështje e gjykuar Res Judicata sipas nenit 105 par. 2016 të LPP-së.**

Sa i përket arsyes së eliminimit se kemi ofruar një faturë në gjuhën gjermane, sqarojmë se ky dokument bën pjesë në dispozitat e nenit 65-71, e që në këto raste lejohen të kërkohe s qarime sipas nenit 72 të LPP-së. Këtë situatë e ka qartësuar edhe interpretimi i KRPP tek pyetja Nr.7, ku ndër të tjera ceket “*Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohe nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument*”.

Në këtë rast lejohet të kërkohe s qarime dhe AK-ja është dashur të kërkojë s qarime pavarësisht se fatura është një dokument që mund të kuptohet lehtë pothuajse në cilën do gjuhë.

Pavarësisht kësaj dispozite, në këtë rast nuk ka nevojë të kërkohe s qarime shtesë sepse fatura nuk përbën ndonjë relevancë sepse me dosje të tenderit është bashkangjitur urdhërpagesa në gjuhën shqipe për eskavator (skip) me luge ngarkuese para dhe prapa e dt.10.05.2024, prandaj kjo dëshmi është relevante dhe e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Mbi këtë bazë sqarojmë se ne jemi eliminuar padrejtësisht në këtë aktivitet të prokurimit.

Pas pranimit të njoftimit mbi vendimin përkatësisht formularit B58, ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo përsëri nuk na është lejuar qasje e plotë në dokumentet e këtij grupi të OE.

Me qasje na është dorëzuar një kërkesë për qarime e dt.25.02.2025 dërguar grupit të OE të rekomanduar për kontratë, ku sqarimet janë kërkuar si më poshtë:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Në lidhje me aktivitetin e Prokurimit “ RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët”

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

*Tek Kapaciteti teknik dhe financiar: Kërkesa 1. Kërkesa 1 OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. Kërkesa 2 OE duhet te kete te paktën 50.000,00 Euro asetë likuide ne llogarin bankare ose qasje per kredi nga ndonje banke.*

*Dëshmia 1 Deklarata nga ATK ose raport financiar. Dëshmia 2 Deklarata nga banka qe verteton disponueshmërinë ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartëcekur.*

*Komisioni profesional për Egzaminimin dhe Vlerësimin e Ofertave kërkon sqarim ne oferten tuaj lidhur me letërperkrahjen që e keni dorëzuar së bashku me ofertë. Aty ceket se “banka do të shqyrtojë financimin e aktivitetit në fjalë në procedurat e saj të brendshme”. Ndërsa sipas kërkesës së dosjes së tenderit ka qenë që ju të dorëzoni deklaratë nga banka që vërteton disponueshmërinë në llogari OSE vertetim bankar që kompania mund të marr kredi në shumën e lartëcekur.*

Që te vlerësojmë në mënyrë të duhur ofertën tuaj ju lutem na sqaroni se ju si GOEJANA SH.P.K & EL-BAU SH. P.K se a keni poseduar mjete te gatshme në llogari bankare sipas kërkeses së lartëcekur.

Sqarimet janë kërkuar, mirëpo përgjigjet dhe dëshmitë të cilat janë ofruar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk na janë dhënë me qasje në dokumente, duke u arsyetuar se dokumenti nga banka është sekret afarist i përcaktuar sipas aneksit 3. Në lidhje me këtë çështje ekspertja shqyrtuese e edhe paneli shqyrtues e kishte konstatuar se deklarata nga Banka nuk është sekret afarist, prandaj në këtë rast nuk është respektuar edhe vendimi i panelit shqyrtues PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025.

Nuk është respektuar neni 10 i LPP-së e po ashtu edhe neni 11 i LPP-së sepse nuk është arsyetuar deklarata për sekret afarist, e po ashtu AK-së nuk ka përgatit versionin e pastruar në lidhje me dokumentet e konsideruara sekret afarist nga ana e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.

Ligjërisht nuk mund të kërkohej sqarime për këtë çështje-dokument të Bankës, sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë me dosje të tenderit ka bashkangjitur një dokument nga Banka, e cili nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit, prandaj çfarëdo dokumenti që është ofruar më pastaj me sqarime nuk mund të merret parasysh sepse sqarimi i kërkuar është i kundërligjshëm.

Se deklarata nga Banka nuk ka qenë sipas kërkesës e ka konstatuar edhe ekspertja shqyrtuese dhe këtë konstatim e ka mbështetur paneli shqyrtues në vendimin PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025, duke e konsideruar të papërgjegjshëm këtë grup të OE.

Megjithatë sqarojmë se ky grup i operatorëve ekonomik është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim.

- Grup i Operatorëve Ekonomik **Jana SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K** është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

**Kerkesa 1** OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. **Kerkesa 2** OE duhet te kete te pakten 50.000,00 Euro asetet likuide ne llogarin bankare ose qasje per kredi nga ndonje banke.

**Deshmia 1** Deklarata nga ATK ose raport financiar. **Deshmia 2** Deklarata nga banka qe verteton disponueshmerin ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartcekur,

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50,000.00 euro ose vërtetim bankar që kompania mund të marr kredi në shumën e lartcekur, por i njëjti grup i OE ka ofruar letër përkrahje e cili nuk është aprovim kreditor por është vetëm një letër e cila i sqaron procedurat e përkrahjes së subjekteve juridike, e që kjo letër i lëshohet secilit OE që e kërkon, e ku sqarohet se nëse kërkon mbështetje financiare do të shqyrtohet financimi, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

Gjithashtu në dyshojmë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka vazhduar me kohë validitetin e ofertave dhe sigurimin e tenderit, prandaj kërkojmë që të sqarohet ky pretendim i yni i cili ngritet mbi bazën e dyshimeve pasi që nuk na është dhënë qasje e plotë në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.

- Grup i Operatorëve Ekonomik **KUSHTRIMI NM SH.P.K.; AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Xhemshir Sejdiya B.I.** është i papërgjegjshëm sepse diplomën dhe kontratën e punës për inxhinierin Skender Cakja e ka ofruar të pa Noterizuar, prandaj është i papërgjegjshëm.

Për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv **Zymer Gaga** është ofruar kontrata e punës e pa Noterizuar, prandaj është i papërgjegjshëm ky grup i OE.

Për inxhinierin e hidroteknikes z.Sadik Pllana është ofruar kontrata e pa Noterizuar, prandaj është i papërgjegjshëm ky grup i OE.

Po ashtu edhe për inxhinierin e Gjeodezisë është ofruar kontrata e punës e pa Noterizuar prandaj është i papërgjegjshëm ky grup i OE.

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (n) është kërkuar certifikatë për menaxhimin e mjedisit ne punishte, kurse grupi i OE në fjalë ka ofruar një certifikatë për z Kushtrim Misini e cila është ISO STANDARD 14001:2015 për sistem të menaxhimit të mjedisit, mirëpo askund nuk shkruan se është për menaxhim të mjedisit në punishte, e që realisht kjo dëshmi nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj ky grup i OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

**Në dosje të tenderit është kërkuar certifikatë, kurse ky grup i OE ka ofruar iso standard.**

Po ashtu i njëjti grup nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit.

Po ashtu pajtohem me arsyen e eliminimit të këtij grupi të OE, që e ka cekur AK-së në vlerësimin e kaluar, si në vijim:

JU për ta plotësuar këtë kërkesë të kërkuar në Dosjen e tenderit dhe Njoftimit për Kontrate ,keni dorëzuar deklaratat nën betim por që Tre Anëtarët e Grupit kanë përdorur Ankesin 2. i



cili i referohet aktivitetit me titull- Rregullimi i shtratit të lumit në fsh. budrig e ulët ,me numër të prokurimit -658-24-6178-5-2-1, e jo aktivitetit për të cilin keni ofertuar e i cili mban këtë titull : RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit të lumit në fsh. budrig e ulët , dhe këtë me numër të prokurimit : 658-24-7751-5-2-1 . Bazuar në këtë të gjetur dhe meqenëse Deklarata nën Betim është kusht administrativë , komisioni vlerëson se ky GOE-ve nuk e kanë plotësuar këtë kusht administrativë.

Pra edhe kjo arsye e eliminimit është edhe pretendim i yni ankimor.

Gjithashtu i njëjti grup nuk ka vazhduar edhe validitetin e ofertave.

- Grup i Operatorëve Ekonomik **Eco Holding Group SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K** është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (e) është kërkuar personel i certifikuar për gdhendje dhe muratim te gurëve, ndërsa grupi i OE në fjalë për këtë kërkesë ka prezantuar një certifikatë për z Shpetim Sahiti i certifikuar për Muratim me tulla dhe Blloqe dhe materiale për muratim, prandaj kjo certifikatë nuk e plotëson kërkesën e cekur më lartë dhe për këtë arsye është dashur të eliminohet nga konkurrenca ky grup i OE.

**Kerkesa 1** OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. **Kerkesa 2** OE duhet te kete te pakten 50.000,00 Euro asete likuide ne llogarin bankare ose qasje per kredi nga ndonje banke.

**Deshmia 1** Deklarata nga ATK ose raport financiar. **Deshmia 2** Deklarata nga banka qe verteton disponueshmerin ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartcekur.

Grupi i OE në fjalë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50,000.00 euro ose vërtetim bankar që kompania mund të merr kredi në shumën e lartcekur, por i njëjti grup i OE ka ofruar letër përkrahje e cili nuk është aprovim kreditor por është vetëm një letër e cila i sqaron procedurat e përkrahjes së subjekteve juridike, e që kjo letër i lëshohet secilit OE që e kërkon, e ku sqarohet se nëse kërkon mbështetje financiare do të shqyrtohet financimi, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

**Po ashtu i njëjti grup nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit.**

- Grup i Operatorëve Ekonomik Euro Commerc; **ARLINDI SHPK; LEDI SH.P.K.** - RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (n) është kërkuar certifikatë për menaxhimin e mjedisit ne punishte, kurse grupi i OE në fjalë ka ofruar një certifikatë për z Fatlind Musa e cila është ISO STANDART 14001;2015 edhe për auditor, mirëpo askund nuk shkruan se është për menaxhim të mjedisit në punishte, e që realisht kjo dëshmi nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit , prandaj ky grup i OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Në dosje të tenderit është kërkuar certifikatë, kurse ky grup i OE ka ofruar iso standard.

**Grup i Operatorëve Ekonomik Euro Commerce; ARLINDI SHPK; LEDI SH.P.K.,** Viti, nuk ka vazhduar validitetin e ofertës prandaj edhe për këtë arsye është i papërgjegjshëm.

Të tre grupet e OE të lartcekur janë shpallur të papërgjegjshëm edhe me vendimin PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025, prandaj këto pretendime janë Res Judicata për tre OE e lartpërmendur dhe për grupin e OE të rekomanduar për kontratë sepse me vendim të OSHP- janë konfirmuar papërgjegjshmëritë e këtyre grupeve të operatorëve ekonomik.

Ne me dt.01.04.2025 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, ku e njëjta e ka cilësuar kërkesën tonë si të pa bazuar, mirëpo që arsyetimin e saj nuk e ka mbështetur në fakte dhe dispozita konkrete ligjore.

Autoriteti kontraktues në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket pajisjeve ka dhënë përgjigjen si në vijim:

Sa i përket pretendimit tuaj ankimor, AK konstaton se sipas letres standarde të eliminimit ku ju kemi cekur se për mjete që i nënshtrohen regjistrimit ju nuk keni ofruar këto pajisje të regjistruara siq kërkohet me Ligjin 05/L-132 për automjetet dhe Udhëzimin Administrativ MPB nr. 01/2018 për regjistrim të automjeteve.

Ndërsa sa i përket konstatimit nga ana e juaj se këto mjete nuk regjistrohen, nuk qëndron sepse sipas nenit 39, pika 3 (Në trafikun rrugor nuk mund të marrin pjesë njetet e paregjistruara si motokultivatori dhe **mjete të punës. Nëse këto mjete marrin pjesë në trafikun rrugor duhet të jenë të regjistruara dhe t'i kenë sistemet dhe pajisjet e përcaktuara teknikisht në rregull**).

Ndërsa OE i shpallur fitues për të plotësuar kërkesën e DT dhe NJK këto pajisje i ka ofruar me regjistrim valid duke dëshmuar rregullsinë e tyre teknike. Andaj, pretendimi juaj është i pabazuar.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se siç e kemi sqaruar edhe më lartë makineritë e kontestuar nga AK nuk janë obligative të regjistrohen. Ky pretendim i yni ankimor është çështje e gjykuar Res Judicata sipas nenit 105 par. 2016 të LPP-së, sepse e njëjta është trajtuar në vendimin PSH.Nr.2024/1144 të dt.23.01.2025, ku është konstatuar se ne jemi eliminuar pa ndonjë të drejtë ligjore nga ana e AK-së. Andaj në këtë rast nuk mund dhe nuk është dashur të eliminohej me një arsye të tillë përderisa vet OSHP-ja e ka vërtetuar faktin se ne jemi eliminuar padrejtësisht nga ky aktivitet i prokurimit.

Gjithashtu ne edhe një herë po e sqarojmë se në ligjin Nr.05/L-132 për Automjete, nuk është e obligueshme që pajisjet të cilat përdoren **vetëm në kantier të regjistrohen.**

Kur kemi parasysh dëshminë e kërkuar dokumentare tek dosja e tenderit dhe duke u bazuar në nenin 9, paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.05/L-132 për Automjete, **makineritë që janë të dedikuara për përdorim në kantier ndërtimi janë të përjashtuara nga homologimi dhe rrjedhimit, nga regjistrimi i detyrueshëm.**

Pra sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht Ligjit Nr.05/L-132 për Automjete:

-Dudat doganorë,

-Librezat e automjeteve për makinerinë që kanë nevojë për kycje në komunikacion,

-Dokumentacionin për makineritë punuese dhe pajisje të tjera, që janë të përjashtuara nga regjistrimi sipas legjislacionit në fuqi.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, ne për makineritë të cilat nuk janë të obligueshme të regjistrohen kemi prezantuar dëshmitë sipas kërkesës, andaj në asnjë mënyrë arsyetimi i

autoritetit kontraktues për eliminimin dhe refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk është i qëndrueshëm.

Për pretendimin tonë ankimor në lidhje me arsyen e eliminimit tonë për faturën në gjuhën gjermane AK-ja ka dhënë arsytimin si në vijim:

Ndërsa pretendimi juaj se fatura nuk përbën ndonjë relevancë nuk qëndron sepse në DT dhe NJK është kërkuar qartë se *Deshmia 1. per te gjitha paisjet qe rrethohen kerkohet deshmi mbi pronen e tyre , librezat e qarkullimit me rrethim valid, per paisje qe nuk rrethohen kerkohet deshmi mbi pronen (kontrat e blerjes,fatura ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshtruar dhe vulosur nga dy palat dhe e noterizuar . Pra sikur te kishte ekzistuar dokumenti lidhur me faturën në njërin nga gjuhët zyrtare sipas LPP-së, të njëjtin është dhatur të bashkangjitur në ofertë apo në kërkesën për rishqyrtim me datë para hapjes së ofertave dhe e njetat të ishte e noterizuar, por një të tillë ju nuk e keni ofruar në ofertën tuaj.*

Pra shihet qartë se sipas DT dhe NJK askund nuk është kërkuar që të urdhërpagesa, por është kërkuar që të ofrohet per te gjitha paisjet qe rrethohen kerkohet deshmi mbi pronen e tyre , librezat e qarkullimit me rrethim valid, per paisje qe nuk rrethohen kerkohet deshmi mbi pronen (kontrat e blerjes,fatura ose Dud doganor.

Andaj, AK konstaton se pretendimi juaj është i pabazuar.

Arsytimi i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se urdhërpagesa është dokument financiar që vërteton se pagesa është kryer. Përderisa është bashkangjitur urdhërpagesa në gjuhën shqipe për eskavatorin (skip) me lugë ngarkuese para dhe prapa, atëherë e njëjta është një provë e qartë dhe relevante konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Tek arsyetimi tjetër për pretendimin tonë ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë sa i përket dokumentit nga banka, AK-ja përsëri është arsyetuar se dokumenti i tillë është sekret afarist, ndërsa e ka cekur se në sqarimin që OE i rekomanduar për kontratë e ka bërë, ka dëshmuar që ka mjete të gatshme në llogari bankare sipas DT.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se në lidhje me këtë çështje ekspertja shqyrtuese e edhe paneli shqyrtues e kishte konstatuar se deklarata nga Banka nuk është sekret afarist, prandaj në këtë rast nuk është respektuar edhe vendimi i panelit shqyrtues PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025. Ndërsa sa i përket sqarimeve të cilat i janë kërkuar OE të rekomanduar për kontratë gjatë fazës së rivlerësimit, ju sqarojmë edhe një herë se ligjërisht nuk mund të kërkohej sqarime për këtë çështje-dokument të Bankës, sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë me dosje të tenderit ka bashkangjitur një dokument nga Banka, e cili nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. Prandaj çfarëdo dokumenti që është ofruar më pastaj me sqarime nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh sepse sqarimi i kërkuar është i kundërligjshëm.

Dokumentin nga banka të cilin e kishte bashkangjitur OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij, e kishte vërtetuar edhe ekspertja shqyrtuese se deklarata nuk është sipas kërkesës dhe këtë konstatim e kishte mbështetur paneli shqyrtues në vendimin PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025, duke e konsideruar të papërgjegjshëm këtë grup të OE. Në këtë rast AK-ja përveç se nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së, e njëjta në çdo mënyrë po e tregon haptas favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm.

AK-ja nuk ka dhënë përgjigje fare në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket dyshimeve për mos vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit me kohë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, andaj në këtë rast po rriten dyshimet tona se pretendimi ynë është i qëndrueshëm. Kërkojmë nga ana e panelit shqyrtues dhe ekspertit shqyrtues të OSHP-së që ti analizojnë detaje dokumentet e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike.



Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se vendimi i tillë nuk është i bazuar në asnjë dispozitë ligjore dhe njëkohësisht i njëjti është në kundërshtim me vendimin e PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

#### VENDIM

- I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e Grupi të OE Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK.
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi** i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

#### 9. Dëmet materiale

Përkrahur mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve na janë shkaktuar dëme në vlerë rreth 5 mijë euro deri më tani.

#### KRITERET PËR VLERËSIM

### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kerkesa 1 OE per perfundimin e ketij projekti duhet te kete te perfunduar se paku tri kontrata ne tri vitet e fundit per pune te ngjajshme ( kolektor,kanalizim ose ujesjelles) ne vlere jo me pak se 300.000,00 euro. Kerkesa 2 OE duhet te kete staf te mjaftueshem a) nje inxhinier i ndertimtarise - drejtimi konstruktiv per menaxher te projektit me pervoj pune se paku deri pese vite pervoj pune ; b) udheheqes i punishtes - Ing. i dip. i Hidroteknikes me pervoj pune se paku tri vite; c) nje ing. ose bachellor i diplomuar i ndertimtarise drejtim hidroteknik se paku tri vite pervoj pune; d) nje ing. i diplomuar i gjeodezise me minimum tre vite pervoj pune; e) Nje punetore i qertifikuar per gedhendje dhe muratim te gureve me pregaditje shkollore min. shkolla e mesme; f) nje punetore i certifikuar per beton-arne pregaditja min. shkollen e mesme; n) nje punetore i certifikuar per menaxhimin e mjedisit ne punishte me minimum tri vite pervoj me pregaditje shkollore min. shkolle te mesme; nj) nje teknik te diplomuar te ndertimtarise me pervoj pune min. tri vite pervoj pune.

OE per kryerjen e ketij projekti duhet te posedoj mekanizem te mjaftueshem dhe ate 1).Kamion transportues me kapacitet jo me pake se 10 m3 - 2 cope, 2).kamion kiper me peshe bartese mbi 6

Deshmia 1.OE duhet te dorezoj nje liste kontratave te realizuara ne tri vitet e fundit per punet e kryera duke saktësuar vleren e kontrates, data e fillimit te implementimit dhe data e perfundimit gjegjesisht pranimin e punimeve kontrates i bashkangjiten referenca per te njejtat kontrata dhe pranimet teknike te punimeve nga ana e komisionit . Deshmia 2.Lista e stafit profesional te angazhuar ne kete projekt e nenshkruar dhe vulosur, vendimin me shkrim per emrimin e menaxherit te te projektit per pozitat nen a-d kerkohet CV ja , kontrata e punes , deshmi mbi pervojen dhe diploma kopje e noterizuar .per pozitat nen e-nj kerkohet kontrata e punes , deshmi pervoja e punes , certifikat profesionale , diplom nese per staf profesional dhe teknik ndihmes ka marveshje bashkpunimi marveshja duhet te jete e nenshkruar , vulosur dhe e noterizuar .

Deshmia 1. per te gjitha paisjet qe rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronsin e tyre , librez e qarkullimit me rexhistrim valid, per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi

B05 Njoftim per Kontrat

4 / 7

ton - 2 cope, 3).Eskavator per germim 6-15 ton - 1 cope, 4).Eskavator per germim mbi 20 ton -1 cope, 5).Cilinder per ngjeshje deri ne 5 ton -1 cope, 6).Cilinder per ngjeshje deri 3 ton - 1 cope, 7).Autofshise speciale per pastrim pas perfundimit te punimeve - 1 cope, 8).Rul ngjeshes (viber pllake) - 2 cope, 9).Damper mbi 3 ton - 1 cope, 10).Semafor sinjalizues per menaxhimin e komunikacionit - 1 cope, 11).Kamion per terheqjen e ujevare fekal me kapacitet minimum 10 ton - 1 cope, 12).Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa - 2 cope.

pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar .

Mos ofrimi i qasjes ne disa dokumente zyrtare .

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

**Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:**

Komisioni i RI - Vlersimit gjate egzaminimit ,vlerimit dhe krahasimin te ofertave ka konstatuar se ;Nga OE pjesmarres ne kete tender qe gjithesejt ishin pese operator ekonomik vetem nji ofert eshte e pergjegjshme.

Komisija za procenu, tokom ispitivanja, procene i poređenja ponuda, utvrdila je da: Od EO koji su učestvovali na ovom tenderu, od kojih su svi bili pet ekonomskih operatera, samo jedna ponuda je odgovorna.

**INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK**

N/A

**VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP**

OE ankues është palë me interes

**VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME**

Jo perveq vendimit per këtë aktivitet te permendur ne faqen e parë

**ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME**

NA

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Dua arch SH.P.K.****

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e lëndës, konstatojmë si në vijimë:

**Përgjigje në Pretendimin nr. 1.**

OE “Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK ,pretendon se A.K.,

Komuna Partesh nuk e ka respektuar qellimin e nenin 1 të LPP-së

Ekspertja thekson se ndër tjera qellim i ketij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë menyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen,nga personat ,operatoret ekonomik ,dhe nga autoritetet kontraktuese si dhe të siguroj integritetin dhe pergjegjësinë e zyrtarëve public dhe personave te tjerë që janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit .

AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar,duke e njoftuar se nuk janë plotësuar kreteret e kapacitetit teknik dhe professional ,perkatsisht nuk janë përmbushur keto dy kriteret me arsyetimin se nuk janë dorëzuar librezat e qarkullimit per Damber dhe Eskavator shih se si ka qen kriteri me DT dhe NJK :

**Kerkesa :**

9).Damper mbi 3 ton - 1 cope dhe

12).Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa - 2 cope.

**Deshimia:**

Deshmia 1. per te gjitha paisjet qe rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronsin e tyre , librezat e qarkullimit me rexhistrim valid, per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar .

Ekspertja sqaron vlerësimi nuk është bërë në harmoni me nenin 1 të LPP-së sepse nuk janë zbatuar kushtet,rregullat e parapara me dosjen e tenderit sikurse ishte paraparë per keto dy kriteret ku me DT dhe me njoftimin per kontratë per pajisjet qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar , e në rastin konkret kerkesa e paraparë me piken 9 dhe 12 si Damperi dhe Eskavatet dihet se janë mjete te punës dhe te njejtat me paragrafin 1.2 te nenit 9 te Ligjit nr .05/L-132 perjashtohen nga homologimi,ligji i perjashton disa pajisje ushtarake dhe mjetet e punë edhe pse decidivisht nuk e specifikon pajisjet në fjalë mirëpo konsideroj se keto dy lloje te pajisjeve hyjnë te mjetet e punës për qka edhe janë te destinuara dhe te kerkuara per ketë aktivitet të prokurimit ,andaj konsideroj se qendron pretendimi i OE ankues sepse regjistrimi per keto pajisje nuk është i obligueshëm dhe per te njejtat duhet te vlejn deshmit qe janë kerkuar per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar,andaj qendron pretendimi i OE ankues ,e sa i perket fatures



ne gjuhen gjermane do ta gjeni pergjigjjen te pretendimi perkates me posht.

**Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njeiti pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe i njeiti në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së trajtohet si qështje e gjykuar „res judicata”**

Andaj ,

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

**Përgjigje në Pretendimin nr. 2.**

**OE “Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK pretendon se A.K., Komuna Partesh nuk e ka respektuar neninn 7 të LPP-së .**

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Ekspertja sqaron se qendron pretendimi sepse Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar OE ankues për dokumente që nuk ka qen e domosdoshme te dorezohen sikur u sqasua më lart për librezat e qarkullimit me regjistrim valid .

**Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njeiti pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe i njeiti në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së trajtohet si qështje e gjykuar „res judicata”**

Andaj

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

**Përgjigje në Pretendimin nr. 3 dhe 4.**

**OE “Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK pretendon se A.K., Komuna Partesh nuk e ka respektuar neninn 10 dhe 11 të LPP-së .**

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i nenit 10 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë transparente ,pra AK në secilen fazë duhet ti perdor

mjetet për promovimin e transparences qe nenkupton edhe në fazen e qasjes ne dokumente publike ,si dhe ndër të tjera qellim i nenit 11 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet ti trajtojë informatat sekrete afariste .

OE ankues nder te tjera pretendon se per oferten e grupit te OE fitues AK nuk ka dhenë qasje ne terë

oferten-dokumentacionin i njejtë e specifikon se në dokumentin për mbështetje bankare është kërkuar sqarim nga OE fitues dhe deshmimit e ofruara nga banka nuk na janë dhënë në qasje në kete dokument.

Ekspertja sqaron se disa dokumente janë të mbrojtura me legj mirëpo është kusht që për të njëjtat të plotsohet kërkesa për konfidencialitet e cila gjindet në dosjen e tenderit ,gjithashtu ekspertja sqaron se OE i shpallur fitues e ka plotësuar këtë kusht sepse e ka plotësuar kërkesën për konfidencialitet,mirëpo e njëjta konsideron se dokumenti që deshmon se ka perkrashje nga banka nuk hynë të dokumentet konfidenciale sepse i njëjti ishte kriter i pararë me NJK dhe DT dhe i njëjti leshohet nga banka me qëllim që të deshmohet se OE ka perkrashje apo mundë të marr kredi në vlerën e paraparë nga autoriteti kontraktues,**mirëpo** me rastin e sqarimeve grupi i OE i shpallur fitues nuk ka sjellur dokument për perkrashje nga banka i cili dokument nuk do të ishte sekret afarist siq kemi theksuar edhe me ekspertizen paraparake,por grupi i OE ka sjellur dëshmi bankare që posedon mjete financiare ma shumë se sa që janë kërkuar ky dokument konsideroj se e plotëson kriterin e paraparë sepse dëshmia që posedon mjete financiare është ekuivalente apo edhe ma e favorshme se sa dokumenti që leshon banka për perkrashje,pra me rastin e Ri-vlerësimit AK ka kerkua sqarime në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe sqarimet janë bërë përmes platformes se e-prokurimit dhe me keto sqarime grupi i OE i shpallur fitues ka deshmuar se e plotëson këtë kriter,pra ka ofruar dëshmi të nxierr me datë 05.08.2024 se posedon 81,436.28€,pra edhe dita e hapjes së ofertave ishte 05.08.2024 andaj nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse ky dokument ka numrin e gjirrollogaris dhe konsideroj se hynë në dokumentet konfidenciale andaj sqaroj se dokumenti e plotëson kriterin e paraparë dhe i njëjti hyn të dokumentet konfidenciale.

Ndërsa qasje për valeditetin e dhe sigurimin e tenderit nuk është konfidenciale dhe për të njëjtat qëndron pretendimi i OE ankues

Andaj

Ekspertja sqaron se ky pretendim është pjesërisht i bazuarë.

#### **Përgjigje në Pretendimin nr. 5 nr.6,nr 7,nr.8 dhe pretendimi nr. 9. dhe 10**

**OE “Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK pretendon se A.K., Komuna Partesh nuk ka respektuar nenin 59,60,69 dhe 72 të LPP-së,si dhe neni 40 të RRPP-së dhe neni 10 i udhëzuesit për prokurimim publik nr 001/2023 si dhe vendimin e OSHP-së nr 2024/1144 i dt 23.01.2025**

Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i nenit 59 të LPP-së dhe nenit 40 të RRPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit,i cili pasi i ka vlerësuar ofertat e pranuar ka dhënë rekomandim dhe i njëjti rekomandim është aprovuar nga udhëheqesi i prokurimit,gjithashtu Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i nenit 60 dhe 69 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese në respektimin e kriterëve për dhenjen e kontrates dhe respektimin e kriterëve për nga aftësia teknike dhe profesionale ,gjithashtu ekspertja sqaron se qëllimi i nenit 72 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese për mundësin e sqarimit të dokumenteve gjatë fazës së vlerësimit për dokumentet ekzistenca e tecilave është fikesuar para skadimit të afatit për dorëzimin e

tendereve ,qe nderlidhet edhe me

neni 10 i udhezuesit per prokurimim publik nr 001/2023 si dhe vendimin e OSHP-së nr 2024/1144 i dt 23.01.2025 .

**OE ankues nderë tjera pretendon se** oferta e tijë padrejtesisht është trajtuar se nuk i ploteson keto kritere si :

**Kerkesa :**

9).Damper mbi 3 ton - 1 cope dhe

12).Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa - 2 cope.

**Deshimia:**

Deshmia 1. per te gjitha paisjet qe rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronsin e tyre , libreza e qarkullimit me rexhistrim valid, per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar .

Ekspertja sqaron se siq u sqarua ne pretendimin nr 1 kjo pikë pretenduese është e bazuarë sepse OE ankues është eliminuar per keto dy pajisje se nuk kan librezë për qarkullim me regjistrim valid ,ekspertja sqaron se ky eliminim nuk është i bazuar ne kritert e parapara me NJK dhe DT sepse per pajisjet qe nuk regjistrohen nuk është kerkuar Libreza per ma gjeresisht shih kriterin ma lart dhe sqarimin ne pretendimin nr 1 te kesaj ekspertize .

**OE ankues pretendon se** : sa i perket fatures e cila është në gjuhen gjermane e nuk është në gjuhet e lejuara siq është Gjuha Shqipe ,Gjuaha angleze dhe Gjuha serbe,OE ankues pretendon se perveq kesaj fature është bashkangjitur edhe urdherpagese në gjuhen shqipe për eskavator (skip) me luge ngarkuese para dhe prapa e dates 10.05.2024 dhe i njejt pretendon se kjo deshmi është relevante me faturen dhe ploteson kriterin e paraparë me dosjen e tenderit ,i njejt thekson se me interpretimin nr 7 është sqaruar se per dokumentet qe bejn pjesë ne nenin 65 -71 te LPP-së ne perputhje me nenin 72 të LPP-së mund te kerkohet nga OE qe te dorezojë një perkthim zyrtar të të njejtit dokument .

Ekspertja me vemendje e ka analizuar ketë pretendim dhe sqarimin e KRPP-së dhe vjen ne perfundim se qendron pretendimi i OE ankues sepse parimisht per faturen e dorëzar në gjuhen gjermane në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përktim zyrtar të të njëjtit dokument.

,se ky pretendim qendron e ka vertetuar Opinioni I KRPP-së nr. 7 . ku me te njejtin opinion lejohet te kerkohen perkthime per dokumentet qe bejn pjesë ne nenin 65-71 të LPP-së ku edhe fatura benë pjesë ne keto dokumente per te cilat KRPP ka sqarua se lejohet te dorzohen perkthime per keto dokumente,shihe Opinionin e KRPP-së :

## **7. 22.11.2022 A duhet të refuzohet tenderi apo të kërkohet sqarime sipas 72, i cili ka sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me LPP?**

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron OPINIONIN si në vijim:

Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton:

“13.4 Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”

Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përsëritet në format standarde të dokumenteve të tenderimit të miratuara nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me LPP.

Sipas dispozitave të lartpërmendura tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur.

Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 13 të LPP-së dhe format standarde (dokumentet e tenderimit), KRPP ofron këtë OPINION:

Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësojë tenderin.

Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:

1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;

2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Sipas përvojës, në fakt, specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze.

Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike.

Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit.

3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit

Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

4) parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore të tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar. Në të kundërt, në rastin e përmendur, OE ka paraqitur në një gjuhë tjetër specifikimet teknike të cilat përfaqësojnë një pjesë thelbësore dhe të nevojshme për pranimin e tenderuesit.

Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet.

Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument.

Andaj .

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

**OE ankues nderë tjera pretendon se OE i shpallur fitues është i pa pergjegjshëm me arsyet e si me poshtë :**Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50 mijë euro ose vërtetim bankar që kompania mund të merr kredi në shumën e lartcekur, dhe thekson se per kete kriter nuk mundë te kerkohet sqarime ,gjithashtu thekson se per kete pretendim është konstatuar nga Ekspertja shqyrtuese dhe i njejti konstatim është mbështetur nga paneli shqyrtues me nr 2024/1144 .

Ekspertja paraprkakisht ne ekspertizen paraparake e ka analizuar Letren e leshuar me date 02.08.2024 nga NLB banka per OE e shpallur fitues dhe bazuar ne konkluzionin e fundit kjo leter nuk e kishte plotesuar kriterin e paraparë me NJK dhe DT sepse nder tjera ne ketë leter shkruan se :Nëse subjekti juridik JANA SH.P.K kërkon mbështetje financiare lidhur me projektin/ tenderin e lartcekur, për shumën deri, por duke mos tejkualuar EUR (me fjalë: EUR



*Pesëdhjetë mijë), banka do shqyrtojë financimin e tij, bazuar në procedurat e saj të brendshme.*

*Ndersa kriteri ka qenë në këtë mënyrë ;*

<b>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b>	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b>
<b>Kerkesa 1</b> OE duhet të ketë se paku në tri vitet e fundit qarkullim në shumen prej 350.000,00 Euro. <b>Kerkesa 2</b> OE duhet të ketë të paktën 50.000,00 Euro asete likuide në llogarin bankare ose qasje për kredi nga ndonjë bankë.	<b>Dëshmia 1</b> Deklarata nga ATK ose raport financiar. <b>Dëshmia 2</b> Deklarata nga banka verteton disponueshmerin në llog. bankare vertetim bankar që kompania mund të marrë kredi deri në shumen e lartecur.

Ekspertja me ekspertizën ka sqaruar se banka ka theksua se nëse subjekti kërkon mbështetje financiare lidhur me projektin ,banka do të shqyrtojë financimin e tij ,sqarim ma i detajuar gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për mbështetje financiare mund të leshohet kredia por edhe mundë të refuzohet ,e që do të thotë se nuk ka deklarata nga banka që verteton disponueshmerin në llogari bankare ose vertetim bankar që kompania mund të marrë kredi deri në shumen e lartecur .

Andaj kishte ardhur në përfundim se ky pretendim është i bazuarë.

**Mirëpome rastin e rivlerësimit** për këtë kriter AK ka kërkuar sqarime shtesë dhe grupi i OE ka dëshmuar se posedon mjete financiare ,ku ka bashkangjitur deklarata nga banka se posedon mjete financiare në bankë ,ma gjerësisht për datën dhe shumën që posedon e gjeni në pretendimin paraprak 3 dhe 4 të këtij raporti,si dhe ndryshimet në Ri-vlerësim që kanë të bëjnë me vlerësimin e par ,pra herën e par AK e kishte marrë si të mirëqen dëshminë nga banka ,ndërsa me rastin e ri-vlerësimit kishte kërkuar informacion shtesë dhe siq u sqarua ma lart OE i shpallur fitues ka sjellur dëshmi se posedon mjete financiare të gatshme pa pasur nevojë për dokument për krahasim nga banka ,pra ky është dallimi që herën e par ishte aprovuar pretendimi ndërsa tani nuk aprovohet i njëjti.

Andaj

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë.

**OE ankues ndërë tjera pretendon se:** OE i shpallur fitues nuk e ka vazhduar valeditetin dhe sigurimin e tenderit ,

Ekspertja sqaron se me datë 01.11.2024 është vazhduar paraprakisht sigurimi i tenderit ku në policën e sigurimit shkruan se kjo siguri vlenë për 90 ditë dhe data e fillimit është 01.11.2024 e që i bjen se tenderi ka sigurim deri me datën 29.01.2025 ndërsa OE i shpallur fitues vazhdimin e sigurimit të tenderit e ka bërë me 03.02.2025 e që nënkupton se me vonesë e ka vazhduar sigurimin e tenderit dhe konstatohet se qëndron pretendimi i OE ankues .

E sa i poerket valeditetit te tenderit nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse OE I shpallur fitues edhe me rastin e dorezimit te tenderit e ka specifikuar se valediteti I tenderit është per 120 ditë edhe ne vazhdimin e par edhe në vazhdimin e dytë e ka bërë për nga 120 ditë e qe nenkupton se nuk ka ra ne vonesa per valeditetin e tenderit por te njejtin e ka vazhduar ende pa i kaluar afati pra valeditetin e tenderit e ka bër pa vonesa sepse hapja ishte berë me daten 05.08.2024 dhe tani me daten 03.02.2025 e ka vazhduar per heren e dytë qe nenkupton se ne te dyja rastet e ka vazhduar para afatit te skadimit .

Andaj

Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuarë.

**OE ankues nderë tjera pretendon se: Grup i Operatorëve Ekonomik KUSHTRIMI NM SH.P.K.; AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Xhemshir Sejdiya B.I.** është i përgjegjshëm sepse diplomën dhe kontratën e punës për inxhinierin Skender Cakja e ka ofruar të pa Noterizuar, prandaj është i përgjegjshëm,I njejta pretendon se ky ofertues nuk e ka vazhduar sigurimin e tenderit dhe pajtohet me eliminimin e tij per shkak te tre antaret e konzorciumit kan perdor deklaratat nenë betim te një aktiviteti tjeter te prokurimit .

Ekspertja sqaron se ky ofertues me te drejt është shpallur i eliminuar sepse mjaftojn deklaratat nenë betim qe nuk janë perdor te ketij aktiviteti te prokurimit dhe te njejtat janë kusht administrativ qe edhe nuk mund te korrigjohen apo te kerkohet ndonje sqarim per te njejtat ,edhe sigurimi i tenderit apo mos vazhdimi i sigurimit te tenderit e eliminon nga gara gjithashtu edhe per kontrata qendron pretendimi i OE ankues.

Ekspertja sqaron se pretendimi është i njejt me pretendimin paraparak,perveq se e ka shtuar edhe si pretendim se OE nuk e ka vazhduar valeditetin e tenderit,andaj edhe një here konstatoj se pretendimi është i bazuar .

Gjithashtu ekspertja sqaron se edhe AK e ka trajtuar si te eliminuar ketë ofertues.

**Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njejt pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe i njejt në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së trajtohet si qështje e gjykuar „res judikata”**

Andaj

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

**OE ankues nderë tjera pretendon se: Grup i Operatorëve Ekonomik Eco Holding Group SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K**

*Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (e) është kërkuar personel i certifikuar për gdhendje dhe muratim te gurëve, ndërsa grupi i OE në fJalë për këtë kërkesë ka prezantuar një certifikatë për z Shpetim Sahiti i certifikuar për Muratim me tulla dhe Blloqe dhe materiale për muratim, prandaj kjo certifikatë nuk e plotëson kërkesën e cekur më lartë dhe për këtë arsye është dashur të eliminohet nga konkurrenca ky grup i OE.*

*Kerkesa 1 OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. Kerkesa2 OE duhet te kete te pakten 50.000,00 Euro asete likuide ne llogarin bankare Ose qasje per kredi ndonje banke.*

*Deshmia 1 Deklarata nga ATK ose raport financiar. Deshmia 2 Deklarata nga banka qe verteton disponueshmerin ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartcekur.*

*Grupi i OE në fjalë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50 mijë euro ose vërtetim bankar që kompania mund të merr kredi në shumën e lartcekur, por i njëjti grup i OE ka ofruar letër përkrahje e cili nuk është aprovim kreditor por është vetëm një letër e Cila i sqaron procedurat e përkrahjes së subjekteve juridike, e që kjo letër i lëshohet secilit OE që e kërkon, e ku sqarohet se nëse kërkon mbështetje financiare do të shqyrtohet financimi, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca.*

**Për : ECO HOLDING GROUP SHPK**  
**Gjilan**

**Nga : BANKA KOMBËTARE TREGTARE KOSOVAË SH.A.**  
**Ukshin Hoti 2 , 10 000 Prishtine, Kosovo**

**Lënda: Mbeshtetje Bankare**

**Titulli: RI-TENDER; Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët**

Me ane te ketij konfirmimi, vërtetojmë se kompania **ECO HOLDING GROUP SHPK** me certifikate biznesi **811915430** eshte klient i bankes tone, dega Gjilan me llogari rrjedhese nr. **196008867031192** dhe perdor produktet e bankes

Nese Kompania “**ECO HOLDING GROUP SHPK**” kërkon te financohet ne vlere prej 50,000, Banka Kombëtare Tregtare do të konsiderojmë mundësinë e financimit, bazuar në kapacitetin e tij financiar, pas analizës financiare të bërë nga analistet tane të kredive.

*njëjti grup nuk ka vazhduar sigurimin e tenderi*

*Po ashtu i*

Ekspertja sqaron se sa i perket pretendimit per stafin se u kerkua personel i certifikuar per gdhendje dhe muratim te gurëve, ndërsa grupi i OE në fjalë për këtë kërkesë ka prezantuar një certifikatë për z Shpetim Sahiti i certifikuar për Muratim me tulla dhe Blloqe dhe materiale për muratim ky pretendim është pjeserisht i bazuar dhe per te njejtin do mundë te kërkohej informacin shtesë bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-së ,mirëpo mos dorezimi –vazhdimi i sigurimit te tenderit e eliminon nga gara ketë ofertues ,si dhe mos plotesimi i kriterit per perkrahje financiare nga banka e eliminon ofertuesin me posht e gjeni deklaraten e bankes e cila nuk e ploteson kriterin e paraparë me NJK dhe DT sepse siq u sqarua ma lart është kerkua deklarati se ky Ofertues perkrahet e jo se do te shqyrtohet kerkesa sepse siq ka theksuar OE ankues te gjitha kerkesat shqyrtohen nga banka mirpo disa aprovohen e disa refuzohen shih nje pjes te letres nga banka

Ekspertja sqaron se pretendimi është i njëjt me pretendimin paraprak, andaj edhe një here konstatoj se pretendimi është i bazuar.

Gjithashtu ekspertja sqaron se edhe AK e ka trajtuar si te eliminuar ketë ofertues.

**Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njëjti pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe i njëjti në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së rekomandohet te trajtohet si qështje e gjykuar „res judicata”**

Andaj

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

**OE ankues nderë tjera pretendon se:Grup i Operatorëve Ekonomik Euro Commerc; ARLINDI SHPK; LEDI SH.P.K. -**

*Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (n) është kërkuar certifikatë për menaxhimin e mjedisit ne punishte, kurse grupi i OE në fjalë ka ofruar një certifikatë për z Fatlind Musa e Cila është ISO STANDART 14001 ;2015 edhe për auditor, mirëpo askund nuk shkruan se është për menaxhim të mjedisit në punishte, e që realisht kjo dëshmi nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit , prandaj ky grup i OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.*

Ekspertja sqaron se z. Fatlind Musa është i çertifikuar me ISO STANDARD 14001:2015 e qe nenkupton se ka qertifikatë te njohur nderkombetarisht, e sa i perket pretendimit se e njejta nuk është adekuate per menaxhimin e mjedisit në punishte ekspertja sqaron se AK mund te kerkojë sqarime nga leshuesit e kesaj qertifikate se e njejta a ka te bej me ketë veprimtari apo ma drejtë të themi me qellimin per te cilin është kerkuar per menaxhimin e mjedisit në punishte,dhe nese e njejta ka ndonjerin nga keto attribute te pranohet nga autoriteti kontraktues .

Ekspertja sqaron se pretendimi është i njëjt me pretendimin paraprak,perveq se e ka shtuar edhe si pretendim se OE nuk e ka vazhduar valeditetin e tenderit,andaj edhe një here konstatoj se pretendimi është pjeserisht i bazuar ,mirëpo tani e kemi një dallim nga konstatimi paraprak sepse mosvazhdimi i valeditetit te tenderit është i mjaftueshëm per eliminimin e ketij ofertuesi dhe ne rastin konkret edhe po te kerkohej sqarime siq u permend ma lart per qertifikatë prapseprap rezultati do ishte i njejte sepse ne platformen e e-prokurimit nuk kemi vrejtur se i njejta ofertues e ka vazhduar valeditetin e tenderit siq ka pretenduar OE ankues .

Gjithashtu ekspertja sqaron se edhe AK e ka trajtuar si te eliminuar.

Andaj

Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjeserisht i bazuarë.



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE **“Dua arch SH.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët”** me numër të prokurimit: **“658-24-7751-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA PARTESH**

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**Dua arch SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët**” me numër të prokurimit: “**658-24-7751-5-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA PARTESH**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA PARTESH**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Dua arch SH.P.K.**

**Teuta Krasniqi**

